



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

NR. 147, DATË 09. 05.2008

PËR

UNIFIKIMIN E USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË PROKURORITË E SHKALLËS SË PARË

Me synim, unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në ligj;

Në mbështetje, të nenit 118 të Kushtetutës, të neneve 24 pikat 4 e vijues të K. Pr. Penale, të neneve 8 pika 2, të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003,

URDHËROJ:

I. UNIFIKIMII USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË PROKURORI.

1. Në Prokuroritë e shkallës së parë, për mënyrën e përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë vendos prokurori i caktuar për ushtrimin e këtyre funksioneve.

2. Vendimi i mosfillimit të procedimit¹, vendimi i pushimit të akuzës ose çështjes², vendimi i pezullimit të hetimit³, kërkesa për caktimin e masave të sigurimit⁴ dhe kërkesat për revokimin dhe/ose ndryshimin e tyre⁵, kërkesat e tjera që i drejtohen gjykatës⁶, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve⁷, kërkesa për gjykimin e çështjes⁸, konkluzionet përfundimtare⁹, si dhe urdhrat në fazën

¹ Shih, neni 291 i K. Pr. Penale

² Shih, po aty neni 328

³ Shih, po aty neni 326

⁴ Shih, po aty nenet 244, 258 e vijues

⁵ Shih, po aty neni 260 e vijues

⁶ Shih, po aty nenet 202, 208, 209, 210, 222, 264, 270, 274, 316, 471 e vijues

⁷ Shih, po aty neni 324

⁸ Shih, po aty neni 331

e ekzekutimit të vendimeve penale¹⁰, mbështetur në kërkesat e ligjit procedural penal formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes¹¹.

2.1 Prokurori i çështjes duhet të diskutojë paraprakisht me drejtuesin e Prokurorisë, kërkesat për caktimin e masave të sigurimit, kërkesat për revokimin dhe/ose ndryshimin e tyre, vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe kërkesat për zgjatjen e paraburgimit, si dhe kërkimet në konkluzionet përfundimtare për deklarimin e fajësisë dhe caktimin e llojit dhe masës së dënimit, me synim për të parandaluar pasojat që mund të shkaktojnë vendimmarrja e pabazuar në ligj dhe në prova. Për këto akte, kur bie dakord, drejtuesi vendos në thembër të aktit nënshkrimin e tij, kopje e cila vendoset në fashikullin e prokurorit.

3. Drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë, para se të nënshkruajnë shkresat për kalimin e akteve të prokurorit në gjykatë ose tek subjektet e tjerë të procedimit penal, para se të vendoset arkivimi i fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara ose të përfunduara, si dhe para se të vendoset arkivimi i praktikave që ata kanë në ndjekje, kanë për detyrë të kontrollojnë bazushmërinë në ligj të akteve dhe të procedimit penal. Ata marrin përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët.

4. Në rastet kur nga kontrolli i ushtruar, kryesisht ose mbi ankim, drejtuesi i Prokurorisë ose prokurori më i lartë, çmojnë se mënyra e përfundimit të hetimit dhe/ose akti procedural i marrë nga prokurori nuk është i mbështetur në ligj dhe/ose në prova apo akti është i paarsyetuar, sipas rastit, mbështetur në dispozitat e K. Pr. Penale ai mund të vendosë:

4.1 ndryshimin ose shfuqizimin e aktit¹² dhe zgjidhjen ligjore përfundimtare të procedimit ose;

4.2 riformulimin e aktit:

a) duke urdhëruar me shkrim të njëjtin prokuror për riformulimin e aktit përkatës¹³, ose;

b) duke vendosur zëvendësimin e prokurorit me një prokuror tjetër¹⁴, ose;

c) duke marrë vetë përsipër zgjidhjen e procedimit dhe riformulimin e aktit përkatës.

⁹ Shih, po aty neni 378/1

¹⁰ Shih, po aty neni 463

¹¹ Në formulimin e akteve procedurale referohuni në modelet e akteve bashkëlidhur urdhrin nr. 148, datë 09. 05. 2008 "Për përdorimin e modeleve të disa akteve kryesore procedurale penale"

¹² Shih, po aty neni 24/5

¹³ Shih, po aty neni 24/4 dhe neni 4/3 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSh"

¹⁴ Shih, po aty neni 27

5. Në rastet kur ushtrohet kontroll në procedimet penale të prokurorëve më të ulët, prokurori më i lartë bën shënimet përkatëse në listën e njohjes me fashikullin e prokurorit, duke shënuar emrin dhe mbiemrin, datën dhe orën që është njohur me fashikullin, si dhe bën shënimet përkatëse dhe nënshkruan¹⁵.

5.1. Në rastet kur procedimi penal analizohet tek drejtuesi i prokurorisë ose tek prokurori më i lartë, konkluzionet e analizës dhe/ose detyrat që dalin formulohen me shkrim dhe nënshkruhen prej tyre.

6. Prokurori mund të bëj ankim tek Prokurori i Përgjithshëm, në rastet kur nuk është dakord me qëndrimin e drejtuesit të Prokurorisë ose të prokurorit më të lartë.

6.1 Ankimi shqyrtohet brenda dhjetë ditëve nga marrja njoftim, duke iu kthyer përgjigje prokurorit ankues.

7. Oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer hetimet dhe në zbatim të nenit 327 të K. Pr. Penale, ka formuluar relacionin shpjegues me sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve, në rastet kur nuk është dakord me vendimin e prokurorit për mënyrën e përfundimit të hetimeve ose cilësimin juridik të veprës penale informon me shkrim sipas shkallës së hierarkisë¹⁶ prokurorin më të lartë, i cili brenda dhjetë ditëve duhet t'i kthejë përgjigje.

8. Në rastet kur nga studimi, analiza, vlerësimi ose verifikimi i akteve apo i procedimit penal që ndjek prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore evidentohen shkelje të ligjit ose akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm, - drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, drejtuesit dhe prokurorët e apeleve, si dhe drejtuesit dhe prokurorët e kësaj Zyre, njoftojnë, menjëherë dhe jo më vonë se shtatë ditë, Prokurorin e Përgjithshëm, duke parashtruar me shkrim shkeljet ligjore të prokurorit ose të oficerit të policisë gjyqësore.

II. NJOHJA, ZBATIMI, KONTROLI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe drejtuesit-prokuror dhe prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

¹⁵ Shih, Formularin "Lista e personave që janë njohur me të dhënat e procedimit penal...", i cili vendoset në fund të fashikullit të prokurorit

¹⁶ Shih, urdhrin nr. datë . 01. 2008 "Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori"

3. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

4. Në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 8. 03. 2007 "Për përmirësimin e punës dhe kontrollit të ndjekjen penale të prokurorit" në **pikën 5.1** tok fjalëshi "*me vendim të arsyetuar të drejtuesit të prokurorisë*" ndryshohet "***me vendim të arsyetuar të prokurorit, pasi merr pëlqimin paraprak të drejtuesit të prokurorisë***".

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA